



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri lëndës: KSC-BC-2023-12
Prokurori i Specializuar k. Hashim Thaçit, Bashkim Smakajt, Isni Kilajt, Fadil Fazliut dhe Hajredin Kuçit

Vendosi: Gjykatësja e Procedurës Paraprake
Gjykatëse Marzhori Masëlo

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 3 tetor 2025

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Vendimi i Pestë mbi Rishikimin e Paraburgimit të Hashim Thaçit

Prokurores së Specializuar
Kimbërli P. Uest

Mbrojtjes së Hashim Thaçit
Sofi Menegon
Luka Mishetiç

Mbrojtjes së Bashkim Smakajt
Xhonatan Ris
Hju Bauden

Mbrojtjes së Isni Kilajt
Ian Eduards
Xho Holms

Mbrojtjes së Fadil Fazliut
Dejvid Jang

Mbrojtjes së Hajredin Kuçit
Aleksandër Admiral

GJYKATËSJA E PROCEDURËS PARAPRAKE,¹ në bazë të nenit 41(6), (10) dhe (12) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe rregullave 56(2) dhe 57(2) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja"), lëshon këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 5 dhjetor 2024 Hashim Thaçit ("z. Thaçi" ose i "akuzuari"), aktualisht në paraburgim në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara ("DHS") në kuadër të procesit në çështjen gjyqësore *Prokurori i Specializuar k. Hashim Thaçit dhe të tjerë*. ("Çështja 06"), iu dorëzua fletarrestimi i lëshuar nga Gjykatësja e Procedurës Paraprake në këtë procedurë,² *proprio motu* dhe pas konfirmimit të aktakuzës kundër tij, Bashkim Smakajt, Isni Kilajt, Fadil Fazliut dhe Hajredin Kuçit ("Vendimi i Konfirmimit").³

¹ KSC-BC-2023-12, F00015, Kryetarja, [Decision Assigning a Pre-Trial Judge](#) (Vendim për Caktimin e Gjykatëses së Procedurës Paraprake), 6 qershor 2024, publik.

² KSC-BC-2023-12, F00037, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën për Fletarrestime dhe Çështje të Lidhura me To* ("Vendimi për Arrestimin"), 29 nëntor 2024, konfidencial, me Shtojcat 1-8, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte. shih* Shtojcën 4 që përmban fletarrestimin kundër z. Thaçi. Versioni i redaktuar publik i parashtrimit kryesor u lëshua më 19 dhjetor 2024, [F00037/RED](#).

³ KSC-BC-2023-12, F00036, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Konfirmimin e Aktakuzës*, 29 nëntor 2024, konfidencial. Versioni i redaktuar publik u lëshua më 12 shkurt 2025, [F00036/RED](#). Më 14 prill 2025, pas vendimit të Panelit të Gjykatës së Apelit, Gjykatësja e Procedurës Paraprake konfirmoi më tej për z. Thaçi formën e përgjegjesisë penale për veprën penale të pengimit të personave zyrtarë sipas Pikave 1, 2 dhe 3 të Aktakuzës së Konfirmuar të 5 dhjetorit 2024, në bazë të nenit 32(3) të Kodit Penal të Kosovës të vitit 2019, Ligjit nr. 06/L-074, (*shih* F00260, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, [Decision Amending the "Decision on the Confirmation of the Indictment" and Setting a Date for the Submission of Preliminary Motions](#) (Vendim për Ndryshimin e Vendimit mbi Konfirmimin e Aktakuzës dhe Caktimin e Datës për Dorëzimin e Mocioneve Paraprake), 14 prill 2025, publik). Më 16 prill 2025, Zyra e Prokurorit të Specializuar dorëzoi aktakuzën e konfirmuar të ndryshuar (*shih* F00264/A02, Prokurorja e Specializuar, [Public Redacted Amended Confirmed Indictment](#) (Version i Redaktuar Publik i Aktakuzës të Konfirmuar të Ndryshuar), ("Aktakuza e Ndryshuar e Konfirmuar"), 16 prill 2025, publik).

2. Më 8 dhjetor 2024,⁴, 7 shkurt 2025,⁵, 7 prill 2025,⁶ 5 qershor 2025,⁷ dhe 5 gusht 2025 (Vendimi i Katërt mbi Paraburgimin"),⁸ Gjykatësja e Procedurës Paraprake urdhëroi vazhdimin e paraburgimit të z. Thaçi.

3. Më 8 shtator 2025, Zyra e Prokurorit të Specializuar ("ZPS") dorëzoi parashtrime mbi rishikimin e rregullt të paraburgimit të z. Thaçi ("Parashtrimet e ZPS-së").⁹

4. Mbrojtja e z. Thaçi ("Mbrojtja e Thaçi") nuk u përgjigj ndaj parashtrimeve të ZPS-së.

II. PARASHTRIMET

5. ZPS-ja kërkon që Gjykatësja e Procedurës Paraprake të vazhdojë paraburgimin e z. Thaçi, sepse nuk ka pasur faktorë ose informacion të ri që do të ndikonin në konstatimet e bëra nga Gjykatësja e Procedurës Paraprake në Vendimin e Katërt të Rishikimit.¹⁰

6. Më konkretisht, ZPS-ja parashtron se paraburgimi i z. Thaçi vazhdon të jetë i domosdoshëm, pasi të tre rreziqet sipas nenit 41(6)(b) të Ligjit, të konstatuar nga

⁴ KSC-BC-2023-12, Transkripti i seancës, Paraqitja e Parë e Hashim Thaçit ("Vendimi për Paraburgimin"), 8 dhjetor 2024, publik, f. 18, rreshtat 10-20.

⁵ KSC-BC-2023-12, F00165, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, [Decision on Review of Detention of Hashim Thaçi](#) (Vendim mbi Rishikimin e Paraburgimit të Hashim Thaçit) ("Vendimi i Parë i Rishikimit"), 7 shkurt 2025, publik.

⁶ KSC-BC-2023-12, F00250, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, [Second Decision on Review of Detention of Hashim Thaçi](#) (Vendimi i Dytë mbi Rishikimin e Paraburgimit të Hashim Thaçit)(Vendimi i Dytë i Rishikimit"), 7 prill 2025, publik.

⁷ KSC-BC-2023-12, F00325, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, [Third Decision on Review of Detention of Hashim Thaçi](#) (Vendimi i Tretë mbi Rishikimin e Paraburgimit të Hashim Thaçit) ("Vendimi i Tretë i Rishikimit"), 5 qershor 2025, publik.

⁸ KSC-BC-2023-12, F00405, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, [Fourth Decision on Review of Detention of Hashim Thaçi](#), (Vendimi i Katërt mbi Rishikimin e Paraburgimit të Hashim Thaçit), 5 gusht 2025, publik.

⁹ KSC-BC-2023-12, F00438, Prokurorja e Specializuar, *Parashtrime të Prokurorisë mbi Rishikimin e Paraburgimit të Hashim Thaçit*, 8 shtator 2025, konfidenciale. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 11 shtator 2025, F00438/RED.

¹⁰ Parashtrimet e ZPS-së, para. 3-4, 7, 9.

Gjykatësja e Procedurës Paraprake në lidhje me z. Thaçi, mbeten të pranishëm në këtë fazë.¹¹

7. Gjithashtu, sipas ZPS-së asnjë prej kushteve të mundshme për lirim ose garancitë e dhëna nga z. Thaçi nuk mund t'i zvogëlojnë siç duhet këto rreziqe të cilat, të marra veç e veç ose së bashku, mund të trajtohen në mënyrë efektive vetëm në objektin e paraburgimit të DHS-së.¹²

8. Së fundi, ZPS-ja parashtron se koha e shkurtër që ka kaluar nuk ndikon në përfundimin e arritur nga Gjykatësja e Procedurës Paraprake në Vendimin e Katërt i Rishikimit se mbajtja në paraburgim e z. Thaçi mbetet proporcionale pasi: (i) ndaj z. Thaçi janë ngritur njëmbëdhjetë (11) akuza për vepra penale sipas nenit 15(2) të Ligjit dhe, nëse shpallet fajtor, ai mund të dënohet me burgim të gjatë; dhe (ii) ecuria e shpejtë në vijimësi e këtij procesi mbështet mbajtjen në paraburgim të z. Thaçi.¹³ Në lidhje me këtë, ZPS-ja parashtron se zhvillimet më të fundit që nga Vendimi i Katërt i Rishikimit mbështesin konstatimin e mëparshëm të Gjykatës së Procedurës Paraprake se vazhdimi i paraburgimit të z. Thaçi është proporcional.¹⁴ Në veçanti, ZPS-ja thekson: (i) dorëzimin e ardhshëm të dosjes paraprake, të listës së dëshmitarëve dhe të provave materiale, më 19 shtator 2025, dhe të dosjeve paraprake të mundshme të Mbrojtjes më 20 tetor 2025, dhe në vijim kalimin e shpejtë të çështjes trupit gjykues; (ii) ecurinë në vijimësi në lidhje me hapa hetimorë të rëndësishëm; (iii) dorëzimin nga ZPS-ja të njoftimit të katërt sipas rregullës 102(3) të Rregullores, dhe nxjerrjen në vijimësi të materialeve të kërkuara ekipeve të Mbrojtjes të të gjithë të akuzuarve; (iv) apelet e pranuar që rezultojnë nga mocionet paraprake që janë shtjelluar tashmë dhe në lidhje me të cilat pritet vendimi i Panelit të Gjykatës së Apelit; dhe (iii) rezultatet e kontrollimit të telefonave të sekuestruar

¹¹ Parashtrimet e ZPS-së, para. 5.

¹² Parashtrimet e ZPS-së, para. 5.

¹³ Parashtrimet e ZPS-së, para. 6.

¹⁴ Parashtrimet e ZPS-së, para. 6.

që i janë dhënë dhe vazhdojnë t'i jepen të akuzuarit në vijimësi.¹⁵ ZPS-ja shton gjithashtu se z. Thaçi vazhdon të njihet gjithnjë e më shumë me provat kundër tij përmes procesit të nxjerrjes në vijimësi të materialeve.¹⁶

III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

9. Në pajtim me nenin 41(6) të Ligjit, DHS-ja urdhëron arrestimin dhe paraburgimin e një personi vetëm kur: (a) ekziston dyshimi i bazuar se ai ose ajo ka kryer vepër penale brenda juridiksionit të DHS-së; dhe (b) ekzistojnë arsye të artikulueshme për të besuar se personi: (i) mund të arratiset; (ii) do të asgjësojë, fshehë, ndryshojë ose falsifikojë provat e një veprë penale, ose do të pengojë ecurinë e procesit penal nëpërmjet ushtrimit të ndikimit mbi dëshmitarët, viktimat ose bashkëkryerësit; ose (iii) do të përsërisë veprën penale, do të përfundojë një krim të mbetur në tentativë ose do të kryejë një krim të cilin ka kërcënuar se do ta kryejë.

10. Sipas nenit 41(10) të Ligjit dhe rregullës 57(2) të Rregullores, deri në momentin kur aktgjykimi merr formë të prerë ose deri në lirim nga paraburgimi, pas dy (2) muajsh nga vendimi i fundit për paraburgimin, paneli i ngarkuar me çështjen, shqyrton nëse ekzistojnë ende arsyet për mbajtje në paraburgim dhe nxjerr vendim për vazhdimin ose ndërprerjen e paraburgimit.

11. Në pajtim me nenin 41(12) të Ligjit, krahas masës së paraburgimit, për të siguruar praninë e të akuzuarit, përfshirë nëpërmjet videokonferencës, për të parandaluar përsëritjen e veprës penale, ose për të siguruar kryerjen e suksesshme të procedurës penale, nga DHS-ja mund të urdhërohen masat në vijim: fletëthirrja, arrestimi, dorëzania, arresti shtëpiak, premtimi për të mos u larguar nga vendbanimi, ndalimi për t'iu afruar vendeve apo personave të caktuar, paraqitja në stacion të policisë apo në ndonjë vend tjetër dhe masa alternative shmangëse.

¹⁵ Parashtrimet e ZPS-së, para. 6.

¹⁶ Parashtrimet e ZPS-së, para. 7.

12. Sipas rregullës 56(2) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake siguron që personi të mos mbahet në paraburgim për një periudhë të paarsyeshme para fillimit të çështjes dhe, në rast të ndonjë vonese të paarsyeshme të shkaktuar nga Prokurori i Specializuar, pasi ka dëgjuar palët, paneli mund ta lirojë personin me kushte që i gjykon të përshtatshme.

IV. DISKUTIM

A. STANDARDI I ZBATUESHËM

13. Standardi që rregullon paraburgimin është trajtuar gjerësisht në vendime të mëparshme dhe përfshihet këtu përmes referencave.¹⁷ Gjykatësja e Procedurës Paraprake do të zbatojë këtë standard edhe në këtë vendim.

B. DYSHIMI I BAZUAR

14. Gjykatësja e Procedurës Paraprake rikujton se në Vendimin e Konfirmimit u konstatua se, në bazë të nenit 39(2) të Ligjit, ekziston dyshimi i bazuar mirë se z. Thaçi është penalisht përgjegjës për vepra penale që përfshihen në juridiksionin e DHS-së, konkretisht shkelje e fshehtësisë së procesit, mosbindje ndaj gjykatës dhe pengim i personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare dhe brenda kuptimit të neneve 392, 392, dhe 401 të Kodit Penal të Kosovës të vitit 2019, Kodi nr. 06/L-074, përkatësisht, në shkelje të nenit 15(2) të Ligjit.¹⁸ Këto konstatime u bënë mbi bazën e një standardi më të lartë se ai i dyshimit të bazuar që kërkohet sipas të nenit 41(6)(a) të Ligjit.¹⁹ Gjykatësja e Procedurës Paraprake vëren se në këtë çështje gjyqësore nuk ka pasur zhvillime që do t'i ndryshonin këto konstatime.

¹⁷ Shih [Second Review Decision](#) (Vendimi i Dytë i Rishikimit), para. 14-15 (kriteret e përgjithshme), 16 (dyshimi i bazuar), 19-22 (domosdoshmëria e paraburgimit), 36 (lirimi me kusht), 40 (proporcionaliteti), dhe referencat që citohen në të; [First Review Decision](#) (Vendimi i Parë i Rishikimit), para. 12-13 (kriteret e përgjithshme), 14 (dyshimi i bazuar), 17-20 (domosdoshmëria e paraburgimit), 37 (lirimi me kusht), 41 (proporcionaliteti), dhe referencat që citohen në të;

¹⁸ [Confirmation Decision](#) (Vendimi i Konfirmimit), para. 313(a). Shih më lart poshtëshënimin 3.

¹⁹ Shih [Confirmation Decision](#) (Vendimi i Konfirmimit), para. 42-43; dhe [Decision on Arrest](#) (Vendimi mbi Arrestimin), para. 43. Shih ngjashëm, BC-2020-04, F00224/RED, Gjykatësi i Procedurës Paraprake,

15. Rrjedhimisht, në mungesë të ndonjë informacioni apo zhvillimi të ri që provon të kundërtën, Gjykatësja e Procedurës Paraprake konstaton se vazhdon të ekzistojë dyshimi i bazuar se z. Thaçi ka kryer vepra penale brenda juridiksionit të DHS-së, të përcaktuara në nenin 41(6)(a) të Ligjit.²⁰

C. DOMOSDOSHMEËRIA E PARABURGIMIT

1. Rreziku i arratisjes

16. Në lidhje me rrezikun e arratisjes sipas nenit 41(6)(b)(i) të Ligjit, Gjykatësja e Procedurës Paraprake gjykon se të gjitha konstatimet e bëra në Vendimin e Katërt të Rishikimit janë ende të vlefshme, përkatësisht: (i) pesha e veprave penale për të cilat z. Thaçi akuzohet në këtë proces dhe dënimi i mundshëm në rast se shpallet fajtor; (ii) qëllimet keqdashëse të z. Thaçi ndaj ligjeve dhe rregullave të DHS-së; dhe (iii) mjetet dhe mundësia që ka për t'u arratisur edhe pse mbahet në paraburgim në procesin e Çështjes 06.²¹ Gjykatësja e Procedurës Paraprake i kushton vëmendje gjithashtu faktit se z. Thaçi vazhdon të njihet gjithnjë e më shumë me provat që mbështesin akuzat kundër tij, si rezultat i procesit të nxjerrjes në vijimësi të tyre.²²

17. Bazuar në sa më lart dhe në mungesë të ndonjë informacioni të ri që tregon të kundërtën, Gjykatësja e Procedurës Paraprake arrin në përfundimin se në këtë moment vazhdon të ekzistojë rreziku që z. Thaçi të arratiset.

[Public Redacted Version of Decision on Review of Detention of Pjetër Shala](#) (Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Rishikimin e Paraburgimit të Pjetër Shalës), 22 qershor 2022, publik, para. 24; dhe F00075, F00075/RED, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, [Public Redacted Version of Decision on Review of Detention of Pjetër Shala](#) (Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Rishikimin e Paraburgimit të Pjetër Shalës), 10 shtator 2021, publik, para. 22.

²⁰ *Shih ngjashëm*, [Fourth Review Decision](#) (Vendimi i Katërt i Rishikimit), para. 16; [Third Review Decision](#) (Vendimi i Tretë i Rishikimit), para. 18; [Second Review Decision](#) (Vendimi i Dytë i Rishikimit), para. 17-18. *Shih gjithashtu*, [First Review Decision](#) (Vendimi i Parë i Rishikimit), para. 7; Vendimi mbi Paraburgimin, f. 15, rreshtat 1-7.

²¹ [Fourth Review Decision](#) (Vendimi i Katërt i Rishikimit), para. 17; [Third Review Decision](#) (Vendimi i Tretë i Rishikimit), para. 19; [Second Review Decision](#) (Vendimi i Dytë i Rishikimit), para. 23. *Shih gjithashtu*, Vendimin mbi Paraburgimin, f. 18, rreshtat 16-24; [Decision on Arrest](#) (Vendimi mbi Arrestimin), para. 47-48.

²² Gjykatësja e Procedurës Paraprake vë në dukje se që nga [Fourth Review Decision](#), (Vendimi i Katërt i Rishikimit), ZPS-ja ka nxjerrë material shtesë sipas rregullës 102(1)(b) të Rregullores. *Shih, për shembull*, Paketat 59, 61, 64, 68, 70, 71, 74, 76 të Materialit të Nxjerrë.

2. Rreziku i pengimit të ecurisë së proceseve të DHS-së

18. Në lidhje me rrezikun e pengimit të procesit sipas nenit 41(6)(b)(ii) të Ligjit, Gjykatësja e Procedurës Paraprake gjykon se të gjitha konstatimet e bëra në Vendimi e Katërt të Rishikimit janë ende të vlefshme, përkatësisht se: (i) z. Thaçi u koordinua me tre grupe të ndryshme, të cilat i udhëhiqte, për të ndërhyrë në dëshminë e dëshmitarëve të ZPS-së në procesin që po zhvillohet në Çështjen 06, përfshirë duke nxjerrë dhe duke dhënë qëllimisht informacion konfidencial që lidhet me dëshmitarë, dhe duke udhëzuar persona të tjerë që të, dhe për *mënyrën si*, të ndikojnë në mënyrë të paligjshme në dëshminë e dëshmitarëve; (ii) veprimet dhe sjellja e z. Thaçi janë pjesë e praktike më të gjerë përpjekjesh për të ndërhyrë në dëshminë e dëshmitarëve të ZPS-së në Çështjen 06; (iii) veprimet e z. Thaçi tregojnë këmbëngulje për të realizuar përpjekjet e pengimit të procesit të DHS-së nga brenda objektit të paraburgimit të DHS-së, përfshirë përmes përdorimit të ndikimit të tij ndaj ish mbështetësve të UÇK-së që i janë besnik, dhe personave nga qarqet e tij politike, si për shembull të bashkakuzuarit në këtë proces; (iv) konstatimet e mëparshme tregojnë z. Thaçi tentoi të dëmtojë DHS-në se në të kaluarën, dhe ofroi, përmes qarqeve të tij, përfitime personave të thirrur nga ZPS-ja për t'i dhënë informacion ZPS/DHS-së; (v) z. Thaçi është në dijeni të akuzave dhe të provave kundër tij; dhe (iv) dijenia në rritje që ai ka për provat fajësuese kundër tij i jep motiv për të ndërhyrë ndaj dëshmitarëve ose për të penguar ecurinë e këtij procesi.²³

19. Gjykatësja e Procedurës Paraprake rikujton gjithashtu se rreziku i pengimit nuk është eliminuar me përfundimin e paraqitjes së provave të ZPS-së në Çështjen 06, pasi procesi po vazhdon, dhe: (i) në rrethana të jashtëzakonshme, një trup gjykues mund të dëgjojë dëshmi shtesë sipas rregullës 136 të Rregullores, pas

²³ [Fourth Review Decision](#) (Vendimi i Katërt i Rishikimit), para. 19; [Third Review Decision](#) (Vendimi i Tretë i Rishikimit), para. 21-22; [Second Review Decision](#) (Vendimi i Dytë i Rishikimit), para. 28; [First Review Decision](#) (Vendimi i Parë i Rishikimit), para. 29-30; Vendimi për Paraburgimin, f. 12, rreshti 15; [Decision on Arrest](#) (Vendimi mbi Arrestimin), para. 50.

përfundimit të paraqitjes së provave;²⁴ dhe (ii)dëshmitarët që kanë dhënë dëshmi tashmë mund të jenë objekt hakmarrjeje ose të nxiten të tërheqin dëshminë e tyre.²⁵ Gjykatësja e Procedurës Paraprake rikujton më tej se rreziku i pengimit nuk vlerësohet vetëm në raport me Çështjen 06, por edhe në raport me këtë çështje gjyqësore.²⁶ Në lidhje me këtë, Gjykatësja e Procedurës Paraprake thekson se, që nga Vendimi i Katërt i Rishikimit, ZPS-ja ka dorëzuar listën e dëshmitarëve të vet.²⁷ Pasi ka analizuar profilin e dëshmitarëve të ZPS-së që përfshihen në të, Gjykatësja e Procedurës Paraprake është e mendimit se rreziku i ndërhyrjes ndaj dëshmitarëve të ZPS-së në fjalë është i ulët. Megjithatë, kjo nuk e zhvlerëson përfundimin e Gjykatësës së Procedurës Paraprake në Vendimin e Katërt për Rishikimin se vazhdon të ekzistojë rreziku i pengimit, duke marrë parasysh të gjithë faktorët në të cilët u bazua përfundimi.²⁸

20. Së fundi, Gjykatësja e Procedurës Paraprake thekson se ajo vazhdon të vlerësojë aspektet dhe faktorët e mësipërm të marrë së bashku, duke pasur parasysh atmosferën e përgjithshme të frikës dhe frikësimit në Kosovë kundër dëshmitarëve

²⁴ [Fourth Review Decision](#) (Vendimi i Katërt i Rishikimit), para. 19; [Third Review Decision](#) (Vendimi i Tretë i Rishikimit), para. 22.

²⁵ [Fourth Review Decision](#) (Vendimi i Katërt i Rishikimit), para. 19; [Third Review Decision](#) (Vendimi i Tretë i Rishikimit), para. 22. *Shih* KSC-BC-2023-12, IA004/F00005, Paneli i Gjykatës së Apelit, [Decision on Isni Kilaj's Appeal Against Third Decision on Review of Detention](#) (Vendim mbi Apelin e Isni Kilajt kundër Vendimit të Tretë mbi Rishikimin e Paraburgimit) ("Vendimi mbi Apelin e Kilajt"), 1 shtator 2025, publik, para. 74 dhe referencat aty. *Shih gjithashtu*, KSC-BC-2020-06, IA033/F0006, Paneli i Gjykatës së Apelit, [Decision on Rexhep Selimi's Appeal Against Consolidated Decision on Request for Provisional Release and on Review of Detention](#) (Vendim mbi Apelin e Rexhep Selimit kundër Vendimit Përmbledhës në lidhje me Kërkesën për Lirim të Përkohshëm dhe Rishikimin e Paraburgimit), 13 gusht 2025, publik, para. 54; IA035/F00005/RED, Paneli i Gjykatës së Apelit, [Public Redacted Version of Decision on Jakup Krasniqi's Appeal Against Consolidated Decision on Request for Provisional Release and on Review of Detention](#) (Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelin e Jakup Krasniqit kundër Vendimit Përmbledhës në lidhje me Kërkesën për Lirim të Përkohshëm dhe Rishikimin e Paraburgimit), 13 gusht 2025, publik, para. 34.

²⁶ [Fourth Review Decision](#) (Vendimi i Katërt i Rishikimit), para. 19; [Third Review Decision](#) (Vendimi i Tretë i Rishikimit), para. 22.

²⁷ KSC-BC-2023-12, F00459/A03, Prokurorja e Specializuar, *Shtojca 3 e Parashtrimit prej Prokurorisë të Dosjes Paraprake, Listës së Dëshmitarëve dhe të Listës së Provave Materiale*, 19 shtator 2025, konfidenciale (që përmban listën e dëshmitarëve të ZPS-së). ZPS-ja riparaqiti listën pas parashtrimit të versionit të korigjuar të dosjes së saj paraprake (*shih* F00467/A03, Prokurorja e Specializuar, *Lista e Dëshmitarëve*, 26 shtator 2025, konfidenciale).

²⁸ [Fourth Review Decision](#) (Vendimi i Katërt i Rishikimit), para. 27.

aktualë dhe të mundshëm të DHS-së.²⁹ Në këtë kontekst, Gjykatësja e Procedurës Paraprake vlerëson që rreziku që z. Thaçi të ushtrojë presion mbi dëshmitarët është veçanërisht i lartë,³⁰ duke pasur parasysh lidhjet e tij që përmenden më lart.³¹

21. Bazuar në sa më lart dhe në mungesë të ndonjë informacioni që provon të kundërtën, Gjykatësja e Procedurës Paraprake arrin në përfundimin se vazhdon të ekzistojë rreziku që z. Thaçi të pengojë ecurinë e proceseve të DHS-së.

3. Rreziku i kryerjes së veprave penale të tjera

22. Sa i takon rrezikut të kryerjes së veprave penale të tjera sipas nenit 41(6)(b)(iii) të Ligjit, Gjykatësja e Procedurës Paraprake rikujton se, edhe pse ekzistenca e rrezikut të pengimit të procesit nuk nënkupton automatikisht rrezikun e kryerjes së veprave penale të tjera, në këto rrethana, faktorët mbi të cilët mbështetet rreziku i parë janë relevantë edhe për vlerësimin e këtij të dytit.³² Në lidhje me këtë, Gjykatësja e Procedurës Paraprake vë në dukje se, sa i takon rrezikut të pengimit të procesit, faktorët relevantë që duhet të merren parasysh janë të njëjtë me ata të përshkruar në paragrafët e mësipërm 18-20. Pasi ka shqyrtuar nga fillimi këta faktorë, Gjykatësja e Procedurës Paraprake vazhdon të jetë e bindur se ekziston ende rreziku që z. Thaçi të përsërisë veprat penale që pretendohet se ka kryer,

²⁹ [Fourth Review Decision](#) (Vendimi i Katërt i Rishikimit), para. 20; [Third Review Decision](#) (Vendimi i Tretë i Rishikimit), para. 23; [Second Review Decision](#) (Vendimi i Dytë i Rishikimit), para. 30; [First Review Decision](#) (Vendimi i Parë i Rishikimit), para. 31; Vendimi mbi Paraburgimin, f. 18, rreshtat 16-20. [Decision on Arrest](#) (Vendimi mbi Arrestimin), para. 51. *Shih gjithashtu* Vendimin mbi Apelin e Kilajt, para. 83.

³⁰ *Shih* [Fourth Review Decision](#) (Vendimi i Katërt i Rishikimit); [Third Review Decision](#) (Vendimi i Tretë i Rishikimit), para. 23; [Second Review Decision](#), (Vendimi i Dytë i Rishikimit), para. 30, me referencat e cituara në të.; [First Review Decision](#) (Vendimi i Parë i Rishikimit), para. 31.

³¹ *Shih* më lart, para. 18.

³² [Fourth Review Decision](#) (Vendimi i Katërt i Rishikimit), para. 22; [Third Review Decision](#) (Vendimi i Tretë i Rishikimit), para. 25; [Second Review Decision](#) (Vendimi i Dytë i Rishikimit), para. 33; [First Review Decision](#) (Vendimi i Parë i Rishikimit), para. 33; Vendimi mbi Paraburgimin, f. 15, rreshtat 3-7. [Decision on Arrest](#) (Vendimi mbi Arrestimin), para. 53.

përfshirë në lidhje me dëshmitarë të cilët kanë dhënë ose mund të japin dëshmi në Çështjen 06 dhe/ose në çështjen aktuale.³³

23. Bazuar në sa më lart dhe në mungesë të ndonjë informacioni të ri që provon të kundërtën, Gjykatësja e Procedurës Paraprake arrin në përfundimin se ende vazhdon të ekzistojë rreziku që z. Thaçi të kryejë vepra penale të tjera.

4. Përfundim

24. Duke pasur parasysh sa më lart, Gjykatësja e Procedurës Paraprake konstaton se aktualisht ka arsye të artikulueshme për të besuar se z. Thaçi mund të arratiset, të pengojë ecurinë e proceseve të DHS-së, dhe të kryejë vepra penale të tjera, çka e bën të domosdoshëm vazhdimin e paraburgimit të z. Thaçi në përputhje me nenin 41(6)(b) të Ligjit. Gjykatësja e Procedurës Paraprake do të vlerësojë në vijim nëse kushtet për lirimin e z. Thaçi mund të zvogëlojnë mjaftueshëm këto rreziqe.

D. LIRIMI ME KUSHT

25. Gjykatësja e Procedurës Paraprake vazhdon të jetë e mendimit se asnjë kusht nuk do të mund të ulë rreziqet ekzistuese në këtë fazë, veçanërisht rrezikun që i akuzuari të pengojë ecurinë e procesit të DHS-së ose të kryejë vepra penale të tjera.³⁴ Në veçanti, Gjykatësja e Procedurës Paraprake është e mendimit se asnjë prej kushteve që mund të vendoset: (i) nuk trajton, për shembull, mundësinë që z. Thaçi të përdorë persona të tjerë ose pajisje komunikimi që u përkasin personave të tjerë, ose t'u kërkojë personave të tjerë të përdorin mjetet e tyre të komunikimit për të ndërhyrë ndaj dëshmitarëve në mënyrë të paligjshme; dhe (ii) nuk mund të

³³ *Shih gjithashtu, [Fourth Review Decision](#) (Vendimi i Katërt të Rishikimit), para. 22; [Third Review Decision](#) (Vendimi i Tretë i Rishikimit), para. 25; [Second Review Decision](#) (Vendimi i Dytë i Rishikimit), para. 33; [First Review Decision](#) (Vendimi i Parë i Rishikimit), para. 34; Vendimi mbi Paraburgimin, f. 18, rreshtat 16-20. [Decision on Arrest](#) (Vendimi mbi Arrestimin), para. 54.*

³⁴ *[Fourth Review Decision](#) (Vendimi i Katërt të Rishikimit), para. 25; [Third Review Decision](#) (Vendimi i Tretë i Rishikimit), para. 28; [Second Review Decision](#) (Vendimi i Dytë i Rishikimit), para. 37; [First Review Decision](#) (Vendimi i Parë i Rishikimit), para. 38; *Shih* KSC-BC-2020-06, IA017/F00011/RED, Paneli i Gjykatës së Apelit, [Public Redacted Version of Decision on Hashim Thaçi's Appeal Against Decision on Review of Detention](#) (Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelin e Hashim Thaçit kundër Vendimit në lidhje me Rishikimin e Paraburgimit), 5 prill 2022, publik, para. 51.*

garantojë monitorimin efektiv të komunikimeve të z. Thaçi. Gjithashtu, Gjykatësja e Procedurës Paraprake mban parasysh në veçanti se, pavarësisht kushteve (nëse lirohet), i akuzuari do të ketë aftësinë, motivin dhe mundësinë të vazhdojë përpjekjet për pengimin e procesit të DHS-së.³⁵

26. Gjithashtu, sipas mendimit të Gjykatësës së Procedurës Paraprake, megjithëse rreziku i mesazheve dhe udhëzimeve të paligjshme nuk mund të eliminohet plotësisht, masat në fuqi në objektin e paraburgimit të DHS-së, të marra në tërësi, ofrojnë garanci të forta kundër vizitave dhe komunikimeve të pamonitoruara me anëtarë të familjes dhe vizitorë të miratuar paraprakisht, me synimin për të zvogëluar sa më shumë rrezikun e pengimit të procesit dhe të kryerjes së veprave penale të tjera.³⁶ Në lidhje me këtë, Gjykatësja e Procedurës Paraprake rikujton se Administratorja dhe paneli, që kanë qasje të pakufizuar në informacionin konfidencial lidhur me dëshmitarët dhe viktimat, mund të ndërmarrin veprime më shpejt se autoritetet e tjera që veprojnë sipas një kornize të ndryshme.³⁷

27. Rrjedhimisht, bazuar në sa më lart, Gjykatësja e Procedurës Paraprake arrin në përfundimin se çfarëdo kushti i arsyeshëm që mund të vendoset nga Gjykatësja e Procedurës Paraprake, mbetet i pamjaftueshëm për të zvogëluar në masën e duhur rreziqet e përcaktuara në nenin 41(6)(b)(i)-(iii) të Ligjit.

³⁵ [Fourth Review Decision](#) (Vendimi i Katërt i Rishikimit), para. 25; [Third Review Decision](#) (Vendimi i Tretë i Rishikimit), para. 28; [Second Review Decision](#) (Vendimi i Dytë i Rishikimit), para. 37; [First Review Decision](#) (Vendimi i Parë i Rishikimit), para. 38.

³⁶ [Fourth Review Decision](#) (Vendimi i Katërt i Rishikimit), para. 26; [Third Review Decision](#) (Vendimi i Tretë i Rishikimit), para. 29; [Second Review Decision](#) (Vendimi i Dytë i Rishikimit), para. 38; [First Review Decision](#) (Vendimi i Parë i Rishikimit), para. 39. *Ngjashëm*, KSC-BC-2020-06, IA010/F00008/RED, Paneli i Gjykatës së Apelit, [Public Redacted Version of Decision on Hashim Thaçi's Appeal Against Decision on Review of Detention](#) (Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelin e Hashim Thaçit kundër Vendimit për Rishikimin e Paraburgimit), 27 tetor 2021, publik, para. 68.

³⁷ [Fourth Review Decision](#) (Vendimi i Katërt i Rishikimit), para. 26; [Third Review Decision](#) (Vendimi i Tretë i Rishikimit), para. 29; [Second Review Decision](#) (Vendimi i Dytë i Rishikimit), para. 38; [First Review Decision](#) (Vendimi i Parë i Rishikimit), para. 39. *Shih ngjashëm*, KSC-BC-2023-10, F00165, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, [Public Redacted Version of Decision on Review of Detention of Haxhi Shala](#) (Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Rishikimin e Paraburgimit të Haxhi Shalës), 9 shkurt 2024, publik, para. 54.

E. PROPORCIONALITETI I PARABURGIMIT

28. Gjykatësja e Procedurës Paraprake rikujton gjithashtu se: (i) z. Thaçi ndodhet në paraburgim që nga 5 dhjetori 2024 në kuadër të këtij procesi;³⁸ (ii) ndaj tij janë ngritur tri (3) akuza për tentim për të penguar persona zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare, katër (4) akuza për shkelje të fshehtësisë së procesit, dhe katër (4) akuza për mosbindje ndaj Gjykatës, për të cilat mund të dënohet, përkatësisht, deri në pesë (5) vjet, tri (3) vjet, dhe gjashtë (6) muaj burgim;³⁹ dhe (iii) rreziqet e përcaktuara në nenin 41(6)(b) të Ligjit (në veçanti rreziku i pengimit të procesit dhe i kryerjes së veprave penale të tjera) nuk mund të zvogëlohen mjaftueshëm me asnjë kusht të propozuar ose kusht shtesë për lirim.⁴⁰

29. Gjykatësja e Procedurës Paraprake mban po ashtu parasysh se, që prej Vendimit të Katërt të Rishikimit: (i) ZPS-ja ka dorëzuar dosjen e vet paraprake dhe listën e provave materiale dhe listën e dëshmitarëve më 19 shtator 2025;⁴¹ (ii) ZPS-ja ka nxjerrë prova të tjera që ka në zotërim sipas rregullës 102(1)(b) të Rregullores⁴² dhe rregullës 103 të Rregullores;⁴³ (iii) ZPS-ja ka dorëzuar njoftimin e saj të katërt sipas rregullës 102(3) të Rregullores⁴⁴ dhe ka nxjerrë disa materiale të kërkuara prej

³⁸ Shih më lart, para. 1.

³⁹ Aktakuza e Ndryshuar e Konfirmuar), para. 45.

⁴⁰ Shih më lart, para. 27.

⁴¹ KSC-BC-2023-12, F00459, Prokurorja e Specializuar, *Parashtrimi prej Prokurorisë i Dosjes Paraprake, Listës së Dëshmitarëve dhe Listës së Provave Materiale*, 19 shtator 2025, publik, me Shtojcat 1-5, konfidenciale. Versioni i korrigjuar u dorëzua më 26 shtator 2025, (shih F00467, Prokurorja e Specializuar, *Parashtrimi i Korrigjuar i Dosjes Gjyqësore Paraprake të Prokurorisë*, 26 shtator 2025, publik, me Shtojcat 1-5, konfidenciale).

⁴² Shih Paketat 59, 61, 64, 68,70, 71, 74, 76 të Materialit të Nxjerrë. Shih gjithashtu, KSC-BC-2023-12, F00420, Prokurorja e Specializuar, *Parashtrime të Prokurorisë sipas Urdhrit F00395* ("Parashtrimet e ZPS-së për Ecurinë"), 25 gusht 2025, konfidenciale, para. 2, 3. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 5 shtator 2025, F00420/RED. Gjithashtu, Gjykatësja e Procedurës Paraprake vë në dukje se kërkesën për të cilën nuk është marrë ende vendim, për nxjerrje të mëtejshme të materialeve sipas rregulla 102(1)(b) të Rregullores (shih KSC-BC-2023-12, F00458, Prokurorja e Specializuar, *Kërkesë e Prokurorisë për Nxjerrjen e Materialeve sipas Rregullës 102(1)(b)*, 19 shtator 2025, konfidenciale, dhe F00462, Prokurorja e Specializuar, *Sqarim në lidhje me Kërkesën e Prokurorisë për Nxjerrjen e Materialit sipas Rregullës 102(1)(b)*, F00458, 23 shtator 2025, konfidencial).

⁴³ Shih Paketën 60 të Materialit të Nxjerrë.

⁴⁴ Shih KSC-BC-2023-12, F00417, Prokurorja e Specializuar, (Njoftimi i Katërt i Prokurorisë sipas Rregullës 102(3), 18 gusht 2025, publik, me Shtojcën 1, konfidenciale.

Mbrojtjes;⁴⁵ (iv) ZPS-ja i ka paraqitur Gjykatëses së Procedurës Paraprake pikat faktike për të cilat palët pajtohen, siç parashihet në rregullën 95(3) të Rregullores;⁴⁶ (v) hapat e mbetur hetimorë të ZPS-së po vijojnë rregullisht,⁴⁷ dhe pas kryerjes së tyre pritet nxjerrje e mëtejshme e materialeve;⁴⁸ (vi) Gjykatësja e Procedurës Paraprake ftoi ekipet e Mbrojtjes që, deri më 20 tetor 2025, të dorëzojnë dosjet e tyre paraprake dhe të njoftojnë ZPS-në për synimin e tyre për të paraqitur arsye për përjashtimin e përgjegjesisë penale;⁴⁹ dhe (viii) Gjykatësja e Procedurës Paraprake informoi palët se ajo synon t'i kalojë çështjen një trupi gjykues në gjysmën e parë të nëntorit 2025, në qoftë se kjo lejohet nga vendimet e ardhshme të Panelit të Gjykatës së Apelit mbi apelet e paraqitura në lidhje me mocionet paraprake.⁵⁰ Rrjedhimisht, sipas mendimit të Gjykatëses së Procedurës Paraprake, procesi po vazhdon të

⁴⁵ Shih Paketat 58, 62, 63, 65, 66, 69, 75 të Materialit të Nxjerrë. *Shih gjithashtu* Parashtrimet e ZPS-së për Ecurinë, para. 17, 19.

⁴⁶ KSC-BC-2023-12, F00469, Prokurorja e Specializuar, Njoftim në lidhje me Faktet e Pranuara, 29 shtator 2025, publik, me Shtojcën 1, konfidenciale.

⁴⁷ *Shih* KSC-BC-2023-12, F00407, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Prokurorisë për Urdhër (F00361) dhe Modalitetet e Mëtejshme për Ekzaminim nga Mbrojtësja e Pavarur*, 5 gusht 2025, konfidencial; F00431, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Vazhdimin e Fazës 2 të Mekanizimit për Ekzaminimin e Materialit të Ruajtur dhe Çështje Përkatëse*, 29 gusht 2025, konfidencial, me Shtojcën 1, konfidenciale; F00432, Mbrojtësja e Pavarur, *Paraqitje e Rezultateve Paraprake nga Mbrojtësja e Pavarur*, 1 shtator 2025, konfidencial, me Shtojcën 1, konfidenciale, dhe Shtojcat 2-5, rreptësisht konfidenciale dhe ex parte; F00433, Administratorja, *Parashtrim i Administratores i 130 Dokumenteve Rezultuese nga Termit e Kërkimit 2 dhe 3, sipas Vendimit F00431, dhe Kërkesë për Shtyrjen e Afatit për Dorëzimin prej Kompanisë për Kriminialistikë Digjitale të Raportit lidhur me Interpretimin e Meta të Dhënave*, 3 shtator 2025, konfidencial, me Shtojcat 1-2, konfidenciale; F00434, Mbrojtësja e Pavarur, *Përcjellje prej Mbrojtëses së Pavarur e Dokumenteve Rezultuese të Redaktuara sipas Vendimit F00431*, 5 shtator 2025, konfidencial, me Shtojcat 1-11, konfidenciale; F00437; F00437, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Prokurorisë për Informacion të Mëtejshëm nga EFC dhe Informacion nga Zyra Administrative*, 8 shtator 2025, konfidencial; F00442, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën për Shtyrje të Afatit për Dorëzimin prej Kompanisë për Kriminialistikë Digjitale të Raportit lidhur me Interpretimin e Meta të Dhënave*, 9 shtator 2025, konfidencial; F00471, Administratorja, *Parashtrim i Raportit të Kompanisë për Kriminialistikë Digjitale sipas Vendimit F00431*, 30 shtator 2025, konfidencial, me Shtojcën 1, konfidenciale; Administratorja, *Raporti i Tretë Mujor i Administratores sipas Vendimit F00350*, 30 shtator 2025, konfidencial.

⁴⁸ *Shih* KSC-BC-2023-12, F00368, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Prokurorisë për Qasje në Material dhe Çështje Përkatëse*, 9 korrik, 2025, konfidencial, para. 53, 57(i), me Shtojcën 1, konfidenciale.

⁴⁹ KSC-BC-2023-12, F00453, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, [Decision on the Remaining Calendar of the Pre-Trial Proceedings](#) (Vendim mbi Pjesën e Mbetur të Kalendarit të Fazës Paraprake) ("Vendimi për Kalendarin e Fazës Paraprake"), 16 shtator 2025, publik, para. 17-18.

⁵⁰ Vendimi për Kalendarin e Fazës Paraprake, para. 23.

kryhet me ritëm të shpejtë, çka bën që çështja të jetë shumë afër kalimit të saj një trupi gjykues.

30. Gjykatësja e Procedurës Paraprake ka vlerësuar në mënyrë të duhur kohën shtesë që z. Thaçi ka kaluar në paraburgim që nga Vendimi i Katërt i Rishikimit, por gjykon se – kur krahasohet me faktorë të tjerë të përshkruar në paragrafët 28-29 më lart – paraburgimi i tij mbetet proporcional.

31. Gjithashtu, sipas nenit 41(10) të Ligjit dhe rregullës 57(2) të Rregullores, paraburgimi i z. Thaçi do të rishikohet në mënyrë të rregullt pasi të kenë kaluar dy (2) muaj nga vendimi i fundit në lidhje me paraburgimin ose në çdo kohë, në bazë të një kërkesë apo proprio motu, kur ka ndryshime të rrethanave që nga rishikimi i fundit.

32. Duke pasur parasysh sa më lart, Gjykatësja e Procedurës Paraprake gjykon se z. Thaçi nuk është mbajtur në paraburgim për një periudhë të paarsyeshme brenda kuptimit të rregullës 56(2) të Rregullores.

V. VENDIM

33. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykatësja e Procedurës Paraprake:

- a. **URDHËRON** vazhdimin e paraburgimit e z. Thaçi;
- b. **URDHËRON** z. Thaçi që, nëse dëshiron, të paraqesë parashtrime lidhur me rishikimin e ardhshëm të paraburgimit deri **të martën, 11 nëntor 2025, në orën 16:00**, me përgjigjet dhe kundërpërgjigjet sipas afateve të përcaktuara në rregullën 76 të Rregullores; dhe
- c. **URDHËRON** ZPS-në që, në qoftë se z. Thaçi vendos të mos dorëzojë parashtrime deri në afatin e lartpërmendur, të dorëzojë parashtrime për rishikimin e ardhshëm të paraburgimit të z. Thaçi jo më vonë se **të martën, 18 nëntor 2025, në orën 16:00** dhe që z.

Thaçi, nëse dëshiron, të dorëzojë përgjigje jo më vonë se **të martën, 25 nëntor 2025, në orën 16:00.** dhe

- d. **URDHËRON** Zyrën Administrative të riklasifikojë Parashtrimet e ZPS-së (F00438) si publike.

/nënshkrimi/

Gjykatëse Marzhori Masëlo
Gjykatëse e Procedurës Paraprake

E premte, 3 tetor 2025

Në Hagë, Holandë.